


NEWSLETTER  
E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,  
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFLJVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#117



## ARSIMI/ Qeveria miraton 9 bursa për studentë me origjinë shqiptare



Këshilli i Ministrave ka vendosur në mbledhjen e radhës akordimin e 9 bursave të studimit për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, propozim i paraqitur nga Ministri i Shtetit për Diasporën.

Sipas vendimit nëntë bursat për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për vitin akademik 2021-2022 përfshijnë mbulimin financiar për tarifën e studimeve, si dhe shpenzimet e akomodimit e të ushqimit për kohëzgjatjen e vitit akademik të cilat do të përballohen nga buxheti i Agjencisë Kombëtare për Diasporën.

Për vitin akademik 2021-2022 do të akordohen nëntë bursa për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga vendet: dy nga komuniteti arbëresh, dy nga Ukraina, dy nga Kroacia, dy nga Bullgaria dhe një nga Turqia.

## APLIKO TANI

DOKUMENTA BIOMETRIKE

DEKLARIM TË ADRESËS



## "Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimim e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

## VENDIMI/ Miratohen kategoritë që përfitojnë falas tekstet e QBD


Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Shtetit për Diasporën ka miratuar çmimet dhe kategoritë që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2021-2022.

Gjithashtu, Këshilli i Ministrave ka miratuar edhe çmimin e shitjes dhe kategoritë që e përfitojnë falas "Tregime të moçme shqiptare" dhe revista letrare "Letra nga Diaspora".



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë

## PUBLIKIMI/ Del falas online numri i dytë i revistës letrare "Letra nga Diaspora"



Letërsia e migracionit nuk është një fenomen i kohëve të fundit, dhe në historinë e letërsisë shqiptare dëshmi konkrete janë autorët arbëresh. Megjithatë letërsia e krijuar në mërgatë është një dukuri që u konsolidua me hapjen e Shqipërisë dhe valët migratore të fillim viteve '90.

Qendra e Botimeve për Diasporën publikon falas online numrin e dytë të revistës letrare "Letra nga Diaspora".

Janë të shumë autorët shqiptarë që jetojnë dhe krijojnë jashtë kufijve të Shqipërisë, pak të njohur dhe akoma më pak të studiuar. Qendra e Botimeve të Diasporës me qëllim njohjen e autorëve shqiptar në Diasporë sjell botimet e tyre në një revistë, e cila tashmë mund të shfletohet falas online.

CONNECT  
ALBANIA

Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

## VIZITA/ Drejtoresha e QBD në Bibliotekën Qendrore Shqipe në Kroaci

Drejtoresha e QBD-së Mimoza Hysi zhvilloi këtë javë një takim me Dorotea Kerni, drejtuese e Bibliotekës Qendrore Shqipe në Kroaci dhe mësuese e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Zagreb. Znj. Kerni bëri një prezantim të punës si drejtuese e bibliotekës në gjuhën shqipe në Zagreb dhe projektit për ngritjen e këndeve të tjera të gjuhës shqipe në bibliotekat e Rijekës dhe Pulës. Ndër të tjera u diskutua dhe për nevojën e pasurimit të bibliotekave me libra të gjuhës shqipe, për mënyrën e promovimit të kulturës shqiptare në Kroaci, të organizimit të mesimdhënies së gjuhës shqipe etj.

Znj. Hysa e prezantoi me punën e Qendrës së Botimeve për Diasporën në mbështetje të mesimit të gjuhës shqipe në Diasporë dhe për mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen.



## Digjitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## PROPOZIMI/ Bashkëpunim për librat dygjuhësor dhe në gjuhën maqedone



Një mundësi bashkëpunimi për librat dygjuhësh dhe në gjuhën maqedonase është diskutuar mes drejtoreshës së Qendrës së Botimeve për Diasporën Mimoza Hysa me drejtorin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ylber Sela.

Sela prezantoi punën e Agjencisë që drejton dhe paraqiti projektet në zhvillim për mbrojtjen dhe promovimin e gjuhës shqipe si në Maqedoni ashtu dhe në diasporë, duke ftuar njëkohësisht Qendrën e Botimeve për Diasporën për bashkëpunim dhe koordinim të projekteve të përbashkëta.

Drejtoresha Hysa i paraqiti gjithashtu punën e QBD-së dhe sidomos të programit të botimeve dygjuhëshe, duke u ndalur në botimin e fundit të "Tregimeve të moçme shqiptare" të Kutelit.

Aplikacioni Gazeta  
"Diaspora Shqiptare"

Diaspora Shqiptare

SHKARKO  
APLIKACIONIN FALAS

App store: këtu

Play store: këtu